V E N D I M
Nr.372, datë 4.8.1999

PËR SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT PËR STANDARDET DHE RREGULLAT TEKNIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 17 të ligjit nr.8464, datë 11.3.1999 "Për standardizimin", me propozimin e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë,

KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D O S I:

1. Qendra e informacionit dhe shitjes së standardeve, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (DPS), caktohet si pikë referimi për dhënie informacioni për standardet dhe rregullat teknike.

2. DPS-ja merr masa që kjo qendër t'u japë përgjigje të gjitha pyetjeve të arsyeshme që bëhen nga të interesuarit.Qendra jep informacione dhe vë në dispozicion dokumentacionin përkatës në lidhje me:

- çdo rregull teknik të përshtatur ose të propozuar, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, sipas fushave të veprimtarisë që ato mbulojnë;
- çdo standard të përshtatur ose të propozuar, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nga DPS-ja dhe Entet Rregullore të ngarkuara me ligj ose nga organizatat rajonale të standardizimeve në të cilat këto dy institucione janë anëtare me të drejta të plota apo në një nivel më të ulët anëtarësimi;
- çdo procedurë në fuqi për vlerësimin e konformitetit ose e propozuar për të qenë e tillë, me të cilën punojnë ministritë apo institucionet e tjera qendrore sipas fushave të veprimtarisë që ato mbulojnë, si dhe organizatat rajonale në të cilat këto institucione janë anëtarë me të drejta të plota apo në një nivel më të ulët anëtarësimi;
- anëtarësimin me të drejta të plota apo në një nivel më të ulët, të ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore, në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale të standardizimit, të atyre të vlerësimit të konformitetit, si dhe në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe, të cilat janë brenda kuadrit të marrëveshjes me OBT-në. Qendra jep informacion edhe për dispozita ose struktura të veçanta të këtyre marrëveshjeve.
- Vendodhjen e botimeve të ministrive ose institucioneve të tjera qendrore ose ndihmën për gjetjen e një informacioni të tillë, si dhe të qendrave të tyre, në se ekzistojnë të tilla.

3. Sipas kërkesës, qendra u jep kopje të dokumentacionit ministrive, institucioneve dhe subjekteve të interesuara, vendase dhe të huaja, me të njëjtin çmim përveç kostos reale të dërgimit.

4. Informacionet, që i dërgohen Sekretariatit të OBT-së, vendeve anëtare, si dhe subjekteve të veçanta, jepen në gjuhën angleze.

5. Në rastet kur ministritë dhe institucionet e tjera qendrore arrijnë një marrëveshje dy ose shumëpalëshe me një vend tjetër në lidhje me rregullat teknike, standardet ose procedurat e vlerësimit të konformitetit, e cila ka efekt të ndjeshëm në tregti, atëherë njoftohet Sekretariati i OBT-së dhe vendet e tjera anëtare, duke dhënë një informacion të shkurtër për produktet që do të mbulohen nga marrëveshja.

6.Ngarkohen ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, sipas fushave e veprimtarisë që ato mbulojnë, të vënë në dispozicion të DPS-së të gjitha të dhënat e nevojshme sipas këtij vendimi, në gjuhën angleze. Të gjitha kërkesave të bëra nga DPS-ja, në kuadrin e këtij vendimi, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, u japin përgjigje breda 21 ditëve nga marrja e

kërkesës.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko